REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 333-334-350/20
Data/Datum 15.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Ilaz Papaj-Ekspert Shqyrtues	*Data e autorizimit të ekspertit 04.06.2020*	*Data e dorëzimit të raportit 15.06.2020*	*Nr. i lëndës: 333-334-350/20*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën:28.05.2020. OE **"Shkëmbi"Shpk**-Istog.datë 28.05.2020 OE **"Asfalti"Shpk**-Pejë dhe datë OE **"Agim Morina"B.I**-Malishevë kanë parashtruar ankesë me nr:333-334-350/20.kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Mirusha Company"Shpk-Klinë.lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Asfaltimi i rrugës Stup-Zajm-faza tretë"** me nr.prokurimi 634-19-2017-5-1-1.iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **"KK Klinë"**
Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**.Illoji i kontratës: **Kontratë publike.**Punë,vlera e parashikuar e kontratës: **1,100.000.00 €.**

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit OSHP ka nxjerr tri vendime.PSH.nr.453-458/19.datë 05.09.2019. PSH.nr.737-745/19.datë 03.12.2019 dhe PSH.nr.38-41/20.datë 12.02.2020 dhe PSH.nr.202/20.datë 21.04.2020. me të cilët është rekomanduar që aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

Konform nenit 113. 114 të Ligjit Nr. 04/L-042. i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237. Ligjin 05/ L-068. dhe Ligjin 05/ L-092. Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS "SHKËMBI"SHPK

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 51 i LPP-së
Neni 52 i LPP-së
Neni 57 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 108/A i LPP-së
Neni 30 dhe 31 i RRUOPP-së

Nga AK-kemi pranuar vendimin me të cilin ***hudhet e bazuar e O.E.NTP "Shkëmbi Shpl"Istog"****(po e shkruajm ashtu siq është në vendim që ne nuk jemi në gjendje ta deshifrojm se qka ka dasht me tregu AK me këtë dispozitv edhe përkundër që kemi kërkuar sqarim për këtë)që ky vendim është kontuz, pa përmbajtje, I mangët që gjithqka mundet me qenë por jo AKT ADMINISTRATIV i administratës publike sepse nuk ka asnjë kuptim që një vendim të HUDHET i BAZUAR sepse e bazuar nuk mund të hudhet,hudhet si e pa bazuar,është për kegardlije ,e dhimbëshme dhe tragjike të publikohet një vendim i till i institucioneve shetrore nga personat që krijohet përshtypja se .....nuk di si ta emërtojmë.*

Nëse konsultohemi me Ligjin e Përgjithshëm të Proceduarës Administrative ky vendim i AK-Komuna e Klinsë është në kundërshtim me pjesën e tretë të këtij Ligji dhe nenet nga 44 e tutje që rregullojnë AKTIN ADMINISTRATRATIV e në veqanti në kundërshtim me nenin 46,47 dhe 48 dhe si i till duhet të verpohet sipas nenit 52 të po këtij Ligji të shpallet i paligjshëm.

Mendojm se AK-Komuna e Klinës nuk i ka interesuar dhe nuk është marr fare me kërkesën tonë për ri-shqyrtim por vetëm me qdo kusht të mbetet në fuqi vendimi i tyre për dhënie të kontratës,kërkesa jonë për ri-shqyrtim ka qenë e orjentuar kundër njoftimit për dhënie të kontratës dhe letrën standarde për tenderuesit e pasuksesëm për aktivitetin e e prokurimit :"ASFALTIMI I RRUGES STUP -ZAJM FAZA 3"numri i aktivitetit të prokurimit: 634-19-2017-5-1-1, me të cilin njoftim AK ka vepruar në kundërligjshëm me dispozitat e LPP dhe RUOPP,në kundershtim me vendimin nr.PSH.202 20 të OSHPdhe veprimi i AK është i njeanshë dhe subjektiv.

Veprimet e AK si gjatë fazë së ri-vlerësimit dhe ri-shqyrtimit janë në kunërshtim me dispozitat e LPP,me vendimet e saja të më parshme,kundër vednimeve të panelit shqyrtues sepse:rekomandohet për kontratë një OE i cili është i pa përgjegjshëmi njeti nuk ka të vazhduar veliditetin dhe sigurimin e tenderit pas kërkesës së AK për vazhdim të tyre,bie në kundërshtim me vet vendimet e saja që e ka shpall të pa përgjegjshëm me dt.30.12.2019 dhe fare nuk e ka vlersuar gjatë ri-vlersimeve sepse nuk ka qenë na palë me interes juridik dhe material,nuk ka respektuar vendimet e panelit shqyrtues i cili shumë kjartë ka rekomanduar AK të veproj me rastin e ri-vlerësimi për të sqaruar.

Ne jemi të detyruar edhe një herë si shumë herave tjera të ju njoftojmë prapë me këtë zhvillim te ketij aktiviteti të prokurimit si më poshtë:

Nëse e shiqojmë ecurin e këtij aktiviteti të prokurimit gjejmë gjithëqka pos ligjshmëri dhe profesionalizëm krijohet hindja se as vet zyra e prokurimit nuk dinë se qka ka bërë dhe qka duhet të bëjë sepse është e orjentuar që ne mos të jemi fitues i këtij tenderi.

Shtrohet pyetja se pas OE"Mirusha Company"cili OE do të rekomandohet për kontratë sepse OE"Mirusha Company"nga vetë AK është shpallur i pa përgjegjshëm me dt.30.12.2019 sepse pas kërkesës të dt.10.12.2019 për vazhdim të validitetit dhe sigurimit të tenderit OE "Mirusha Company"nuk ka vazhduar validitetin dhe sigurimin e tenderit. për AK-Komuna e Klinës nuk është me rëndësi se i njejti ka hoq dorë nga ky aktivitet i prokurimit edhe për kundër që neni 31.6 i RUOPP qartë e definon këtë qështje.

Nëse e shiqojmë si ka zhvilluar kyj aktivitetit i prokurimit gjatë vlerimit,ri-vlerësimit,ri-vlerësimit.....etj gjejmë se asnjëherë nuk ka konsistencë në vlersimin e ofertave me ofertat e njejta ku poentimi dallon gjdo herë dhe lenë për të dyshuar se kemi të bëjmë me vlerësim paushall dhe i porositur.

Papërgjegjshmëria e AK nuk ka fund ku OE i cili ka refuzuar për të vazhduar validitetin e tenderit dhe sigurimin e tenderit dhe rekomandohet për kontratë në kundërshtim me dispozitat e nenit 57 të LPP dhe nenit 30 dhe 31 të RUOPP,i përkujtojmë AK nenin 31.6 të RUOPP citat: 31.6" ***Është e hapur për secilin OE të vendosë nëse dëshiron të përtërijë validitetin e tenderit apojo. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si "të papërgjegjshëm" dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e***

Tenderit të tyre".
PO ashtu vlerësimi i ofertave të OE të cilët janë shpallur të pa përgjegjshëm edhe nga OSHP „AK i përfshinë prapë në vlerësim el OE "Bujar Shabani B.I. i njëjti nuk ka qenë i përgjegjëm për mungese te vazhdimit te validitetit të ofertës dhe vazhdim të siguricit të tenderit.po ashtu edhe OE"Asfalti"shpk nga Peja me vendim të OSHP është i pa p rgjegjshëm dhe që të dy OE nuk kanë të drejtë fare të vlerësohen nga AK dhe ka qenë detyrim i AK që këta OE të shpallen të pa përgjegjshëm.
Nëse e shiqojmë raportin e vlerësimit të komisionit ri-vlerues shifet tendenca e eliminimit të ofertës sonë ku për nënkriterin e dytë ne poentohemi me 0 pikë edhe përkundër sqarimeve të dhëna pas kërkesës së AK ,kjo lenë për të dyshuar se mendimi i komisionit ka qenë i ndarë paprakisht për OE të cilatuar si ka mundësi që komisioni ri-vlersues vlerson OE"Asfalti "ku OSHP e ka kthyer lëndën në ri-vlersim për arsye se i njëjti nuk ka qenë i përgjegjshëm,pse më parë nuk u rekomandua OE"Mirusha"ku paska qenë i përgjegjshëm edhe pa vazhdim të validitetit pra këtu nuk keni profesionalizëm ligjshmëri dhe konsistenc në vendim marje.
Me këto veprimet me rastin e ri-vlerësimit dhe ri-shqyrtimit AK ka bërë :

-Shkelje të dispozitave esenciale të LPP dhe
-Vërtetim i gabuar i gjendjesë faktike.

Se AK ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjesë faktike kjo dëshmohet nga raporti i vlerësimit të komisionit vlerësues dhe gjatë ri-shqyrtimit që fare nuk ka pas ri-shqyrtim ku për vlerësim janë futur edhe OE të cilët nga vetë AK janë kualifikuar si të pa përgjegjshëm dhe OE te pa përgjegjshëm për të cilët ka vendosur OSHP me vendimet e saja pas shqyrtimit të ankesave ne këtë institucion.Rekomandimet e AK për shpërblim me kontratë OE të pa përgjegjshëm nuk është shenjë e mirë dhe lenë për të dyshuar në profesionalizmin e zyrtarve të AK apo dyshime se ne nuk jemi OE i preferuar i tyre edhe për kundër që jemi të përgjegjshëm.
Se ka shkelje esenciale të dispozitave të LPP kjo është evidente në këtë rast dhe kjo është vërtetuar edhe nga vetë paneli shqyrtues i OSHP i cili disa herë lëndën e ka kthyer të ri-vlerësim.
Mos respektimi i vendimeve të OSHP është shkelje e ligjore sepse AK janë të detyruar të veprojnë konform vendimeve të OSHPi cili institucion është i autorizuar me ligj për të vlersusr ligjshmërin e aktiviteteve të prokurimit.
Ne nuk pajtohemi me vlersimin e ofertës sonë ku për nënkriterin e dytë poentohemi me 0 pikë,komisiani vlerësues ka pas për bazë sqarimet të cilat i kemi dhënë konform kërkesës sp AK sipas rekomandimeve të OSHP-së.
PO ashtu AK nuk ka pas të drejtë të vlersoj dhe poentoj OE "Asfalti"ku me vendim të OSHP eshte i pa përgjegjshëm sepse nuk ka plotësuar kërkesat teknike dhe profesionale si dhe OE "Agim Morina B.I."

Nga kjo shifet qartë se AK-Komuna e Klinës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP ashtu siq e përshkruan më larë :

AK me këtë ka vepruar në kundërshtim me nenin 7.6(v)dhe (vi) citat:" (v) që asnjë
kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e
përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse."

Po ashtu edhe dispozitate nenit 56.3 e qartësojnë këtë qështje sepse nuk mund të vlersohet të eliminohet apo rekomandohet një OE për kontrat për një kërkes.kriter apo specifikim i cili nuk ka qenë kërkesë e DT dhe

njoftimit për kontratë citat i kësaj dispozite:

" 3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohen nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"

Nem 59-4 paashta e trajton dhe rregullon këtë çështje citat :" Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjishëm vetëm nëse tenderi nëjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit....."

Po asht AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 të LPP citat" Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet autoritetet kontraktuese,koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe ose burimet e tilla"

Shkelje të nenit 51 të LPP-së " Autoriteti kontraktues duhet të theksojë në njoftimin e kontratës dhe të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit të gjitha kriteret e përzgjedhjes që një operator i interesuar ekonomik duhet ti përmbushë për tu konsideruar si i kualifikuar: (i) në rast të procedurave të hapura, për dhënien e një kontrate; ose (ii) në rast të procedurave të kufizuara ose të negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës, për të pranuar një fiesë për tenderim. Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e fiesës për tenderim. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji"

Shkelje të dispozitave të nenit 52 të LPP-së 1. Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit do të specifikoj kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës. Kriteret mund të jenë ose emimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm.

2. Nëse autoriteti kontraktues ka specifikuar se kontrata publike do t'i shpërblehet operatorit ekonomik që ka paraqitur tenderin ekonomikisht më të favorshëm, autoriteti kontraktues në fjalë duhet të specifikojë në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit kriteret që do të merren parasysh gjatë vendosjes së fituesit dhe peshën që i është dhënë secilit kriter. Sa më shumë që është e mundshme, autoriteti kontraktues duhet të specifikojë çdo kriter në mënyrë objektive dhe kuantitative si dhe duhet të shprehë peshën që i është dhënë atyre.

3. Vetëm kriteret, e natshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla mund të jenë në lidhje me p.sh., cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike"

Nga të cekturat më lartë gjejmë se AK ka bërë vlerësim sipërfaqsor mos të themi se fare, ka bër vlerësim ku nuk ka respektuar as kriteret për dhënje të kontratës e cila është shkelje e rëndë si dhe nuk ka marr për bazë as kërkesat e DT dhe NJPK,nuk ka vepruar konform vendimit të OSHP-së, ne nuk mund të vlerësojm se cili ka qenë qëllimi por asgjë nuk ka qenë konform LPP-së.
*Nenin 57 lidhur me nenin 31.6 të RUOPP ku neni 31 i RUOPP e sqaron vazhdimin e vlefshmërisë dhe sigurisë së tenderit: **Është e hapur për secilin OE të vendosë nëse dëshiron të përtërijë validitetin e tenderit apojo. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si "të papërgjegjshëm" dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre".***

Ne pas kësaj jemi të detyruar që të drejtën ta kërkojmë në institucionet e sundimit të ligjit sepse ne nuk mund të vazhdojm lojen e ping pongut ashtu siq po dëshironë AK-Komuna e Klinës. këtë jemi të detyrar ta bëjmë sepse duhet të mbrojmë të drejtën tonë e cila po cenohet në vazhdimsi nga ana eAK dhe lidhur me këtë do ti informojmë të gjitha institucionet relevante të drejtësisë dhe ndjekjes.

Andaj Paneli shqyrtues i OSHP me rastin e shqyrtimit të ankesës tonë lidhur me aktivitetin e prokurimit:"ASFALTIMI I RRUGES STUP -ZAJM FAZA 3"Numri i aktivitetit të prokurimit: 634-19-2017-5-1-1 të marr këtë:

V E N D I M

1.Aprovohet si e bazuar ankesa e OE "Shkëmbi"SHPK" lidhur me aktiviteti i prokurimit për tenderin:" ASFALTIMI I RRUGES STUP -ZAJM FAZA 3" Numri i aktivitetit të prokurimit: 634-19-2017-5-1-1".

2.Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin eprokurimit:" ASFALTIMI I RRUGES STUP -ZAJM FAZA 3"Numri i aktivitetit të prokurimit: 634-19-2017-5-1-1 dhe lënda kthehet në ri-vlerësimrekomandohet për kontratë OE"Shkëmbi "nga Istogu.

3.Urdhërohet AK-Komuna e Klinës që me rastin e ri-vlerësimit të veproj konform LPP,kritereve dhe këresave të DT dhe NJPK si dhe vendimit të panelit shqyrtues.

4.Mos zabtimi i vendimit të panelit shqyrtues detyron panelin shqyrtues të veproj konform nenit 131 dhe nenit 25.8 të LPP-ës.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS "ASFALTI" SHPK

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-s
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së
Neni 108/A i LPP-së
Neni 26 i RRUOPP-së
Neni 39 i RRUOPP-së

Neni 1 Qellimi . Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla;

Shkelja e pretenduar :

Ne rastin konkret AK ka bere shkelje sepse : Rekomandon OE i cili ka ofruar qmimin me te larte se sa OE Ankues ne kete rastë Asfalti Shpk per 134.277,31 € duke demtuar shumë rënd buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 6 - Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Shkelja e pretenduar dhe te perseritura ne te njejtin AP eshte e pa-tolerueshme '

AK për te katerten here provon qe te njetin AP ta dergoj tek OE me te shtrejte se sa OE Asfalti Sh.p.k : Ri-kujtojm se :

Vleresim te parë te ofertave kishte rekomanduar OE Drini Compani me qmim me te larte se sa Oferta jone per 92.811,39 € ndersa nga

Ri-vleresimi rekomandon OE Gurëbardhi & Alko Impex per 98.009,42 € me qmim me te larte sesa Asfalti Shpk por edhe ne

Rastin e Ri-Vleresimit te dytë AK prapë rekomandon OE i cili ofron çmimin me te lartë për : 54.941,90 € OE Graniti Skenderaj

Ri-Vleresimit te tretë AK rekomandon OE Asfalti i cili ofron çmimin me te ulët dhe i plotëson te gjitha kriteret , ndersa pason ankesa nga OE Shkëmbi i cili perveq se eshte i pa-pergjegjshem dhe ka ofruar dy-kuptimsi ne formualrin C , i cili me automatizem do te cilesohej i eliminuar per nderhyrje ne formularin C . Paneli Shqyrtues i Oshp-së i jep kete mundesi sqaruese AK ne lidhje me pretendimet ankimore edhe pse Eksperti Shqyrtues e sqaron ne detale pretendimin ankimor te OE ankues dhe rekomandon te mbetet ne fuqi Vendimi i AK por qe Paneli e shef te arsyeshme qe gjate Ri-Vleresimit te hiqen te gjitha dilemat AK merr Vendim te pa-pritur dhe shume skandaloz ne kunderthenje me veten e tyre sepse gjatë :

Ri-Vleresimit te katert Rekomandon nje OE komplet tjeter dhe i cili as validitetin dhe sigurimit e ofertes nuk e ka vazhduar me daten 26.12.2019 (e eliminon me kete arsye) dhe si rezultat ne kete AP OE Mirusha Compani me plote vetedije terhiqet nga ky AP duke mos shpreh interesim per te vazhduar tutje , tani e fusin prape ne procedur te vleresimit sikurse te ishte ne garë e Rekomandojn per dhenje te kontrates ne vlere 134.277,31 € me qmim me te larte sesa OE '' Asfalti '' .

(AK nuk e ka ne konsiderate nenin 6 te Lpp-së si dhe dy Vendimet e Oshp-së) Vendimi nr. 453&458/19 i dates 08.09.2019 ne dispozitivin e vendimit thotë:

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteriu për dhënie të kontratës.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fonde publike dhe burime publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Si dhe Vendimi nr. 757&745/19 i dates 03.12.2019 ne dispozitivin e vendimit thotë:

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pas në dispozicion si dhe të sqarimet e ekspertes profesionale të prokurimit, vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së. Obligohet Autoriteti Kontraktues që gjat rivlerësimit të respektoj ne përmbajtori te gjitha dispozitat e LPP-se si dhe kërkesat e vendosura ne njoftimin per kontrate dhe dosjen e tenderit.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsiderate qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Vendimi 202/20 i datës 21.04.2020 ne dispozitivin e vendimit thotë:

Mosrespektimi i ligjit nga zyrtaret e AK – Komuna e Klinës , dhe mos zbatim te Vendimeve te Oshp-së , kete AP per te pesten here me radhe e dergon ne Organin me te larte te Ankesave , kjo me te vertet eshte nje precedant i pa-kuptimt.

Neni 7 – paragrafi 1.Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabarte dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

AK prape bene shkeljen e radhes edhe pse bazuar ne dy Vendimet e Lartcekura nga Organi Shqyrtues i Prokurimit , gjatë Ri-Vleresimit te dytë AK – Rekomandon nje OE të pa-përgjegjshëm dhe te eliminuar po nga vetë Autoritetit Kontraktues ne Rivleresimin e parë menagjeri i prokurimit z. Abaz Foniqi ishte ne cilësin e Kryetarit te Komisionit Vlerësues (qe per neve eshte edhe nje shkelje nga ana e AK) dhe si perfundim neve ne masë të madhe na Diskriminon dhe Ri-vleresimi i radhës pason me Rekomandim te Grupit te OE i cili nuk i plotëson kriteret e kerkuara nga vete AK , ndersa tani Rekomandon OE qe ne rastin e vleresimit te ofertave te deritanishme e kishte eliminuar japin dy shembuj :

Ne Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna Kline te dates 26.12.2019 permes platformes elektronike ne lidhje me rezultatin e vleresimit keni konstatuar se OE '' Mirusha Compani : eshte eliminuar me keto arsye :

Nuk ju ka pergjigjur kerkeses tuaj te dates : 10.12.2019 ne lidhje me vazhdimin e Validitetit dhe Sigurimit te tenderit , prandaj ju e keni eliminuar me te drejte nga ky AP i cili eshte i nenshkruar nga zyrtari pergjegjes i prokurimit z. Abaz Foniqi (deshmi te bashkangjitur keni Njoftimin e dates 26.12.2019 si dhe letren standarte per kandidatin e eliminuar.

Ne njoftimin e radhes te dates : 13.03.2020 ju prapseprape e keni eliminuar kete OE por tani ne munges te stafit . Cila eshte e Verteta ?

Neni 59 - paragrafi 4 Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të pergjegjshëm vetëm nese tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjithe kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi te cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kusntin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kerkesat e tjera te parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjate vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve

AK neve na ka cilesuar si OE i pergjegjshem qe e fuqizon vete fakti se edhe Eksperti Shqyrtues e ke sqaruar rastin e devijimeve te vogla dhe AK na ka trajtuar te Përgjegjshëm.

Ndersa :

Ak ka bere shkelje duke futur ne Ri-Vleresim nje OE te vetëterhequr (i cili nuk e ka vazhduar validitetin e ofertve dhe Sigurimin sipas thirrjes se AK te dates 10.12.2019)

si dhe i njejti OE ka munges te stafit , nuk e ploteson kete kriter sipas AK ne proceset e vleresimit dhe Ri-vleresimit ne kete AP (rivlersimi i dates 13.03.2020) citojm drejtuar : OE Mirusha Company me Arsyetin se : NUK KENI PREZENTUAR STAFIN E KERKUAR .

OE të Rekomanduar per kontrate ka deshtuar ne permbushjen e kritereve te vendosuar nga AK si ne NJK dhe ne Dosjen e tenderit sepse :

1. ***Anetari i konzorciumit OE Mirusha Compani nuk ka dorezuar deklaraten nen betim siq kerkohet qe eshte ne kundershtim me Lpp-në , prandaj Grupi i OE eshte i pa-pergjegjshem sepse nuk e permbushe pranueshmerin e OE te perjegjeshem.***
2. ***Nuk ka vazhduar Validitetin e ofertes nga data 20.12.2019 per 90 ditë , pra ka shkeputje dhe me Automatizem eshte i pa -- pergjegjshem. (shiqo formularin e njoftimit per kontrate dhe njoftimit te kandidateve) OE Mirusha Company i eliminuar per mos-vazhdim te validitetit dhe sigurimit te ofertave e dates 13.03.2020)***

3. *Sipas vleresimit te komisioneve perkatese edhe ne rastin kur kryetar komisioni ka qene menagjeri i prokurimit z.Abaz Foniqi tre OE te cilet jane eliminuar nga gara per mos vazhdim te validitetit dhe ata jane (Shiqo Raportin e 03.10.2019)*
   - *Victory Invest Suhareke*
   - *Benita Company Klinë*
   - *Jehona Malishevë*
4. *Shkelje e rënd e nenit 59 eshte futja ne vleresim te ofertave pas nje shkeputje te sigurimit dhe validitetit te ofertave nga data 20.12.2019 deri me 05.05.2020 (nese ju e posedoni na e deshmoni por permes platformes elektonike apo emailit zyrtare) edhe pse shifet qarte se ju e keni kerkuar vazhdimin por OE Miruasha Compani nuk e ka vazhduar validitetin dhe sigurimin ne kete periudhe , nuk po kuptoj si ju keni insistuar qe ne shkresen e dates 04.05.2020 te ju kerkoni vazhdimin e validitetit te gjithe atyre OE te cilet nuk kishin vazhduar Validitetin me pare , apo kjo ishte metoda me e persosur qe te ktheni edhe ndonje OE qe te keni mundesi me te medha per perzgjedhje te OE te Rekomanduar , Kjo qeshteje do te trejtohet doemos nga organet kopetente nese ju nuk ndermerrni masat e duhura per te korigjuar keto gabime .*

Me vetë faktin se ky OE nuk ka vazhduar validitetin dhe Sigurimin e ofertes nenkupton se me vatedije eshte terhjekur nga gara e metutjeshme , por se si ka ndodhe qe gjate Ri-Vleresimit te fundit ky OE te vazhdoj validitetin dhe sigurimin me nje fjale te futet ne garë i mbetet Organeve kopetente te merren me kete qeshtje :
Ne kerkuam nje sqarim te tille tek AK por qe nuk na eshte dhene , pra dokumentet inegzistente apo te mos futura ne sistemin e e-prokurimit nenkupton se nuk mund te kerkohen as ne baze te nenit 72. Prandaj ky grup i OE gabimishte eshte vleresuar ne kete fazë.Vleresimi i datës 13.03.2020 e sqaron kete pretendim si dhe 20.03.2020 kur kthyet pergjigjeje ne Kerkesen per Ri-Shqyrtim te OE Shkembi qe nenkupton se ne si OE kemi fituar 100 pike dhe ne ate vleresim nuk ishte OE Mirusha Compani .
Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës , paragrafi 1.2
AK duhet te procedoj sipas keti neni te sigurohet se Grupi i OE eshte i pergjegjeshem e me pastaj te procedoj me nenkritere sipas paragrafit 1.2
Sipas dosjes se tenderit :
[Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kriterave të përshkruara Aneksin 6
1 cmimi .....70 pike
2 mirembajtja . Garancioni i cilesise se punimeve ne muaj.....30 pike
1 CMIMI 0.70
2 OPERIMI MIREMBAJTJA PAS PRANIMIT TEKNIK.PERIUDHA GARANTUESE NE MUAJ 0.30
Siq jeni edhe vete ne dijeni ne nuk jemi leshuar shumë ne elaborimin e OE Shkembi istog por te kihet parasyshe se ky OE ka ofruar mirmbajtejn sipas kerkeses suaj ne vetem 24 muaj (e jo siq pretendohet ne disa nga vleresimet e mehershme se ka 48 muaj apo edhe me shumë) bashkangjitur keni formularin e tenderit qe deshmon se ky OE se bashku me anetarin e konzorciumit ka ofruar 24 muaj mirembajtje , kjo ndryshe mund te konsiderohet edhe si nderhyrje ne formularin C dhe me Automatizen ky grup i OE duhet eliminuar.
Sipas komisionit te Ri-Vleresimit te dates 12.05.2020 ky OE ka dorezuar sqarimet e kerkuara dhe komisioni ne baze te dy kuptimesis ne piken 2 e cila poentohet me 30 pike e ka vleresuar me 00 pikë sqarimi i dates 29.04.2020. i njejti komision nuk eshte bazuar fare ne Rekomandimet e Vendimit nr. 202/20 te Oshp-së i cili qartazi e obligon qe te kerkoj Sqarime ne baze te nenit 72 edhe nese ka ndonje dilem ne lidhje me devijimet e vogla ndaj neve si OE ne rastin e kaluar i Rekomanduar per dhenje te kontrates ai bene Rekomandim plotesishte te gabuar te pa-bazuar ne ligje dhe ne kriteret e vendosura nga vete AK nuk e lexon as qe merret me nenin 116 i Lpp-së paragrafi 6 i cili thotë :

Nje vendim i OSHP-së për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

Si ka mundesi qe ne gare kishin mbetur vetem tri kompani e tani te paraqiten me shume shiqo raportin e ekspertizes :

Pra Rezultati fillestar dihet , OE Shkembi i cili tani u poentua me 00 pike nga 30 piket e mundshme , sesi erdhi deri tek nje OE tjeter i cili ishte komplet jashte gare dhe i cili disa here gjate vleresimeve te mehershme i pa-pergjegjshem dhe per koeqidenc me çmim më të larte prej 134.277,31 € apo 18 % me i shtrejt se OE te cilin ju vete e Rekomanduar per dhenje te kontrates , kjo nuk ka ndonje sqarim tjeter veqse ju si AK jani duke bere shkelje pas shkeljeve dhe asesi te dilni nga nje situate te cilen vete e krijuat duke u arsyetuar ne qmimin ekonomikishte me te favorshem .

Prandaj bazuar ne Lpp-në si dhe Kriterin Kryesor nga neni 60 paragrafi 1.2 mos e keqtrajtoni mundesi qe ju eshte dhene qe kete AP ta hudhni here ne nje kend e here ne tjetrin bazohuni ne vleresimin tuaj te dates 13.03.2020 ku si perfundim kan mbetur vetem 3 OE trajtoni te barabarte keta OE dhe vleresojeni drejte kete AP dhe rezultati do te jete sikurse ai i dates 13.03.2020 sepse po bini ne kundershtim me veten tuaj duke lene shumë per te nenkuptuar dhe doemos per nje vendosje te drejtesis per te cilen jeni thirrur dhe nenshkruer nje deklarate nen betim se do ti permbaheni ligjeve te Republikës së Kosoves ne pergjithesi dhe ne Veqanti Ligjit per Prokurimin Publik . me theks te veqant ne ruajtjen e parase publike dhe Buxhetit te Republikës se Kosovës , Nuk eshte e tolerueshme qe per teke te dikuj per nje AP te shpenzohen 134.277,31 € më shumë nga buxheti i sterngarkuar sidomos ketyre diteve kur c'do aktivitet finaciar si dhe te hyrat buxhetore jane shumë të Limituara.

Ju lutemi mos e demtoni Buxhetin dhe neve si Kompani e cila eshte njera nder kontribuesit e keti buxheti mendoni per pasoja ligjore e ndoshta edhe penale per zvarritje te keti procesi edhe eshtu te sterzgjatur Ri-Vleresojeni me kujdes bazohuni ne parime dhe merrni Vendimin e duhur .

Lusim AK bazuar ne kriteret e vendosura le te procedoj sikurse qe e parashe Lpp-ja dhe ta Ri-Shqyrtoj Kerkesen per Rishqyrtim pran AK bazuar ne F03 Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese

Ne kemi vepruar ne baze te nenit 4 nen b). ndersa

Ju lutemi te veproni ne baze te nenit 6 nen a) dhe me pastaj pas shqyrtimit te Kerkeses sone te merrni VENDIM bazuar ne nenin 8 pika 8.1.2 i.

Duke formuar komision te ri dhe OE te rekomanduar per dhenje ta trajtoj konform kerkesave dhe kritereve te vendosura nga AK ne NJK dhe Dosjen e tenderit

Neni 108/A – Zgjedhja e mosmarreveshjes permes Kerkeses per Ri-Shqyrtim

AK – Nuk ka trajtuar fare Kerkesen tonë per Ri-Shqyrtim dhe njeherit konsiderojm se nuk ka trajtuar pretendimet tona ne lidhje me pranueshmerin e grupit te OE dhe OE te pa-pergjegjshëm e trajton te barabarte me OE te cilet i kane plotësuar te gjitha kriteret dhe kanë ofruar çmimin ekonomikishte me te favorshem sepse ka :

HUDHUR POSHTË Kerkesen per Rishqyrtim duke mos u munduar fare qe te analizoj pretendimet tona apo

nenit e shkelura si dhe Ekzaminimin e fakteve qe ne ju keni dorezuar me rastin e Kerkeses per Ri-Shqyrtim me c'raste hindemi edhe me shumë se grupi i OE eshte ne kundershtimin edhe me nenin 64 dhe 65 te Lpp-së.

Kete fakte se duhet trajtuar kerkesa per Ri-Shqyrtim Aprovuar apo Refuzuar eshtë në baze te Rregullave te Parashtimit te Ankesave por qe te Hudhet e Bazuar . këtë term Juridik nuk e kemi hasur ne ndonjerin nga legjislacionet Primare apo Sekondare ne fuqi te publikuar nga KRPP-ja .

1. *AK nuk i ka shfjelluar piken kryesore te ankeses ku grupi i OE nuk ka vazhduar Sigurimin e tenderit si dhe nuk ka vazhduar Validitetin nga data 20.12.2019 deri me daten 05.05.2020 sipas kerkeses se AK te dates 10.12.2019 si dhe ka kerkuar nga ne te hindemi qe ky AP qenka qmimi ekonomikishte me i favorshem qe sipas tyre OE i rekomanduar zene vendin e parë dhe ne radhitemi te dytet . duke anashkalon faktin se ka kerkuar vazhdim dhe Grupi i OE nuk e ka perfillur ate kerkese dhe vetevetiu ne ate kohe eshte terhequr nga gara sipas dispozitave ligjore dhe sipas vleresimit te vete AK – së ky grup i OE eshte i pa-pergjegjshem .*
2. *nuk ka rendesi sipas tyre fare neni 60 i Lpp-së i cili thote :*
3. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorezuar ose
   1. 2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshen që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 te këtij ligji.
4. Nëse autoriteti kontraktues ka përcaktuar në dosjen e tenderit se kontrata publike do t'i jepet operatorit ekonomik që dorëzon tenderin e përgjegjshëm ekonomikisht me të favorshëm, dhënia e kësaj kontrate do të bëhet vetëm në bazë të kritereve dhe peshës së tyre përkatëse të përcaktuar në dosjen e tenderit në pajtim me paragrafët 2. dhe 3. të nenit 52 te këtij ligji

Rekomandimi i Grupit te OE i cili nuk plotëson kriteret e kerkuara ne NJK dhe DT eshte i pa-pergjegjshëm dhe duhet eliminuar nga gara . e sipas verifikimit te fakteve pra ka nderprerje te vazhdimit te validitetit dhe sigurimit te tenderit .

a) *Me daten 30.12.2019 ne Njoftimin e AK permes formularit B52 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES faqe 1 Radhitur me numer rendor 7 MIRUSHA COMPANY – Kline qmimi 881.853,53€ - I PA PËRGJEGJSHEM .*
b) *Ne po te njejtin vendim por se ne faqe 10 ne NJOFTIMIN PER KANDIDATIN – TENDERUESIN E ELIMINUAR . Mirusha Company eliminohet me Arsyetimin se : NUK JU JENI PERGJIGJUR KERKESES SE A.K. PER VAZHDIM TE VALIDITETIT TE OFERTES DHE SIGURIMIT TE KERKAR ME DATE 10.12.2019 Grupi i OE nuk ka reaguar dhe nuk ka afruar ndonje deshmi.*

KOMUNA KLINË
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-klina.org

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzimeve Operative të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: *ASFALTIMI I RRUGES STUP –ZAJM – FAZA TRETE - RIVLERESIM*

Nr. i Prokurimit:	634	1	9	2	0	1	7	5	1	1
	634	1	9	0	0	2	2	5	1	1

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave[2]					
		VLERA	PIKET	MIRËMBAJTJA	PIKET	TOTALI I PIKEVE	RANGIMI
1.	*ASFALTI SHPK – PEJË*	*347.378.22*	*70.00*	*30 MUAJ*	*12.50*	*82.81*	*2*
2.	GRANITICOM - SKENDERAJ	*362. 516.12*	*65.21*	*72 MUAJ*	*30.00*	*95.21*	*1*
3.	ORINI COMPANY - PRIZREN	*340.387.61*					*3 PAPERGJEGJ ESHEM*
4	GUREBARDHI – KLINË	*834. 585.64*					*3 PAPERGJEGJ ESHEM*
5	AGIM MORINA B.I MALISHEVË	*869.487.13*	*60.19*	*0.00 MUAJ*	*0.00*	*60.19*	*4*
6	BUJAR SHABANI B.I FERIZAJ	*876.275.14*					*3 PAPERGJEGJ ESHEM*
7	MIRUSHA COMPANY – KLINË	*881.851.53*					*3 PAPERGJEGJ ESHEM*
8	BENITA COMPANY - KLINË	*882.474.41*					*3 PAPERGJEGJ ESHEM*
9	SHKËMBI - ISTOG	*889.845.93*	*58.81*	*48 MUAJ*	*20.00*	*78.81*	*5*

[1] Kliko [herdhaj] për të hyrë standardin te njoftimet: B42, B45 dhe B46 (shtoni letrën njofturese sipas rastit).

[2] Në rast të procedurave të kualifikuara/procedurave konkurruese me negociata (*), hapësirën e hyrë standardit njoftimeve: B45 dhe B46 (shto letra standarde sipas nevojës). Dërgo fshirja "Vlera totale e ofertave" nuk përmbahet me të dhënat.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Letër standarde për e eliminuar [1]

KLINE , 26.12.2019
KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, ABEDIN REXHA – KLINË

MIRUSHA COMPANY – KLINE

Titulli i kontratës: *ASFALTIMI I RRUGES STUP -ZAJM – FAZA TRETE - RIVLERESIM*

Nr. i Prokurimit:	634	1	9	2	0	1	7	5	1	1
	634	1	9	0	0	2	2	5	1	1

Të nderuar(a) *[Z.Zajm] [shkruaj emrin e personit kontaktues të operatorit ekonomik]*

Falemnderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin per Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim: "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyjeve në vijim:

Tenderi I juaj është administrativisht e papërgjegjshme:

☐ *Nëse është e zbatueshme, kërkoza fjalia/administrative.*
SIGURIMI I TENDERIT DHE VAZHDIMI I VALIDITEIT TE OFERTES
ARSYETIM

Tenderi juaj nuk është i pranuar për këto arsye :
NUK JU JENI PERGJIGJUR KERKESES SE A.K PER VAZHDIM TE VALIDITEIT TE OFERTES DHE SIGURIMIT TE NENDERIT TE KERKUAR ME DATE 10.12.2019

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk keni qenë në gjendje të përfitoni shërbimet tuaja këtu, bere, besojmë se do të vlerësoni të shfaqni interesim për pjesëmarrje tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,
ARAZ PONIQI
[Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit] *[Nënshkrimi]*

[Ky letër u dërgohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar, tenderët e të cilëve janë refuzuar apo falsifikuese e miratimit apo kanë bërë gabime të pazgjidhshme dhe të pavlerësuar]

Mos Shqyrtimi i pretendimeve ankimore me rastin e Kerkeses per Ri-Shqyrtim na lene te kuptojm se

qellimi i AK eshte qe per te katerten here te rekomandoj OE te pa-pergjegjshem dhe me qnim me te larte sesa oferta jonë:
Sidomos duke mos pasur parasyshe Argumentet nga vete AK , kjo nenkupton se personat e Autorizuar per Ri-Vleresim si dhe Zyrtari i prokurimit nuk zbatojn Lpp-në apo nuk kan njohuri me procedurat qe parashifen ne baze te kopetencave qe ata kanë , Një Grupë të OE i cili me ose pa-qellim pretendon te inkuadrohet pas nje procesi te gjate te Ri-Vleresimeve por me kerkes per vazhdim nga ana e AK kjo nenkupton se ne Komunen e Klines nuk zbatohet ligji dhe se procedurat e vleresimit te tendereve behen AD-HOK dhe Rekomandimet per dhenje te kontrates behen fontan deshirash vetem se kriteri qenka qe te shperblehet me kontrate Operatori Ekonomikishte me i favorshem shtrohet pyetja per kë ME I FAVORSHEM ? .
Andaj vetem analizimi i Vendimit ne pergjigjejen në Kerksen per Rishqyrtim lene shume per te dëshiruar (''HUDHET E BAZUAR ''– ky term i ri Juridik) Vendimi i dates : 26.05.2020 prandaj me Rastin e kthimit ne Ri-Vleresim ne Vendim te Rekomandohet AK qe ne te ardhmen te bazohet ne terme Juridike dhe ne baze te saj te shtjelloj pikat e ankese dhe per secilen pike veq e veq te jape Arsyeshmerin qofshin ato te bazuara apo te pa-bazuara.
Andaj lusim PSH te Oshp-së qe pas ekzaminimit te provave te nxjerre URDHER ne baze te nenit 23 pika 3 per verifikimin e pretendimeve tona (Rregullorja e punës e Oshp-së) dhe te vjen te perfundim qe me VENDIM :
I .Te APROVOHET si e Bazuar Ankesa jonë ,
II. Te Anuloj njoftimin per dhenje te kontrates , dhe AP ta kthej ne Ri-Vleresim
III. Te Urdhëroj AK , qe me rastin e Ri-Vlerësimit ta Respektoj Lpp-në dhe gjatë Ri-Vlerësimit te bazohet ne kriteret e vendosura nga vete AK si ne NJK dhe DT.
IV.Te Kerkenoj zyrtarin e prokurimit dhe AK ne bazë te nenit 131 te Lpp-së ndaj zyrtarit te prokurimit i cili nuk i bindet Vendimeve te Oshp-së andaj lusim PSH qe me URDHËR ti drejtohet AK qe ne te ardhmen do te veprohet ne baze te dispozitave ligjore po qe se vepron ne kundershtim me Vendimet e PSH te Oshp-së

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE "AGIM MORINA" B.I

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 7 i LPP-së
Neni 51 i LPP-së
Neni 56 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 66 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së

Ne si operator Ekonomik Kundërshtojm VENDIMIN e AK- K.K Klinë nr.351-10218/20 datë 26.05.2020 ku me

ane të këtij vendimi ka vepruar në kundërshtim me ligjin e Prokurimit Ojegjësisht e-prokurimi,sepse OE KONZERCIUMI-NNT "BURIMI" Malisheve & KOSOVA ASFALT.është me çmim më të ulët.dhe sipas Njoftimeve katër here rresht arsyeja e eleminimit ka qene se OE"BURIMI" ka qene ne mesin e tendereve që ka plotësuar kushtet sipas kerkeses,por arsyeja e eleminimit është se qmimi nuk është më i ulët sesa operatorti që shpallet fituesandaj ne asnjehere nuk kemi kundershtuar,per deri sa ne vendimin e fundit është vepruar ne kundershtim te Ligjit.si dhe kritereve te kerkuar.

KRITERET PËR VLERËSIM

- IV.2)-Kriteret e Dhënies

-Neni 4.paragrafi 1.26 i LPP-se

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e rivlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni i ri-vlerësimit për këtë aktivitet të prokurimit në raportin e ri-vlerësimit me date 12.05.2020 rekomandojnë për kontratë OE "Mirusha Company" me çmim pref 881,853.53 € i renditur si i pari ne bazë të kriterit të dhënies "Tenderi ekonomikisht me i favorshëm" me 89.34 poena.

Sa i përket ofertës së OE ankues"Shkëmbi"Shpk nga komisioni i ri-vlerësimit kjo ofertë është shpallur e pasuksesshme e cila në bazë të kriterit të dhënies"Tenderi ekonomikisht me i favorshëm" është renditur si oferta e pestë me 58.81 poena.(çmimi i OE ankues është 889,846.00 €).
Oferta e OE tjetër ankues "Asfalti"Shpk nga komisioni i ri-vlerësimit është shpallur e pasuksesshme e cila në bazë të kriterit të dhënies"Tenderi ekonomikisht me i favorshëm" është renditur si oferta e dytë me 88.00 poena.(çmimi i OE ankues është 747,576.22 €).

Oferta e OE ankues "Agim Morina"B.I nga komisioni i ri-vlerësimit është shpallur e pasuksesshme e cila në bazë të kriterit të dhënies"Tenderi ekonomikisht me i favorshëm" është renditur si oferta e tretë me 60.19 poena.(çmimi i OE ankues është 869,847.12 €).

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

-Sqarime shtesë përmes e-mailit me datë 10/06/2020 nga OE i "Shkëmbi"Shpk lidhur me sqarimet e ofruara me kërkesë të AK.
-Pranimi i sqarime nga OE i "Shkëmbi"Shpk me datë 11.06.2020

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26)

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "SHKËMBI" SHPK-ISTOG

Përgjigje në Pretendimin

Lidhur me pretendimin e OE ankues"Shkëmbi"Shpk.se AK gjatë fazës së rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit nuk ka zbatuar drejt vendimin e OSHP-së.PSH.nr.202/20 dhe ka rekomanduar për kontratë ofertën e një OE i cili në vendimet e mëparshme të AK-së është shpallur i papërgjegjshëm dhe si e tillë kjo ofertë duhet të shpallej palë pa interes juridik dhe material.eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Sipas vendimit të OSHP-së.PSH.nr 202/20 të datës 21.04.2020 ku palë ankimuese ka qene OE "Shkëmbi"Shpk ndër të tjera thuhet "Paneli shqyrtues duke pasur parasysh ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit,konsideron se AK nuk ka bërë vlerësimin,ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve konform kërkesave të përcaktuara në dosje të tenderit.Përderisa.AK ka caktuar kriterin "tenderi ekonomikisht më i favorshëm",kontrata duhet ti jepet tenderit i cili më së miri përmbushë kriteret relevante.Përveç çmimit.AK ka përfshirë kritere tjera relevante për lëndën e kontratës, konkretisht njëra prej kritereve ka qenë edhe garancia.Ndërsa.AK gjatë rivlerësimit të ofertave nuk e ka pasur parasysh të sqaroj nëse OE ka ofruar garanci prej 6 vitesh sikurse pretendon në ankesë.Andaj.obligohet AK që gjatë ri-vlerësimit të kërkoj sqarime konform nenit 72 të LPP-së.duke kërkuar nga OE ankues sqarime për periudhën e garancisë.si dhe të sqaroj çështjen e devijimeve.Pastaj.të bëjë vlerësimin e drejtë të poenave konform nën kritereve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë,duke pasur parasysh edhe nenin 59 të LPP-së.

Konform vendimit të OSHP-së.AK gjatë ri-vlerësimit të tenderit me datë 27.04.2020 përmes letrës standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit kërkon nga OE "Shkëmbi"Shpk sqarime lidhur me përshkrimet:
6 VITE GARANCION PER CILESI
2 VITE MIREMBAJTJE DIMERORE .

KERKESA E A.K ESHTE NA SQARONI DETAJISHT CKA KENI KUPTUAR NE ELEMENTIN E PARE – 6 VITE GARANCION PER CILESI
DHE NE ELEMENTIN E DYTE – 2 VITE MIREMBJTJE DIMERORE

OE "Shkëmbi"Shpk me datë 29.04.2020 në përgjigjen e tyre sqarojnë se sa i përket nënkriterit të dytë lidhur me OPERIMI- MIRËMBAJTJA PAS PRANIMIT TEKNIK.PERIUDHA GARANTUESE NË MUAJ kanë dhënë një periudhe garantuese 6 vite që garantojnë për gjithë këtë periudhe kohore lidhur me dëmtimet dhe mirëmbajtjen pas pranimit teknik që nënkupton periudhen garantuese pas pranimit teknik duke garantuar në cilësi dhe mirëmbajtje prej 6 vitesh.ndërsa kanë ofruar edhe një garanci për mirëmbajtje për një periudhë dy vjeçare (24 muaj) në pastrimin dhe mirëmbajtjen gjatë sezonës së dimrit.

Në raportin e ri-vlerësimit të AK të datës 12.05.2020 ky nënkriter i OE ankues"Shkëmbi"Shpk është vlerësuar me 0.00 pikë me arsyetimin se ka ofruar dy varijante(dy kuptimësi) të periudhës së mirëmbajtjes. Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi ankimor është i bazuar sepse AK në raportin e ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar/poentuar drejt nënkriterin e dytë të kriterit "tenderi ekonomikisht më i favorshëm" konform vendimit të OSHP-së.PSH.nr 202/20 dhe sqarimeve të ofruara nga OE "Shkëmbi"Shpk.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues "Shkëmbi"Shpk se AK ka rekomanduar për kontratë ofertën e një OE i cili në vendimet e mëparshme të AK-së është shpallur i papërgjegjshëm dhe si e tillë kjo ofertë duhet të shpallej palë pa interes juridik dhe material.eksperti shqyrtues konsideron se ky pretendim është i bazuar ngase OE i rekomanduar për kontratë "Mirusha Company" Shpk-Klinë në Letrën standarde për tenderuesin e eleminuar është shpallur i papërgjegjshëm me arsyetimin se nuk i është përgjigjur kërkesës së AK për vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimit të tenderit.
Gjithashtu edhe në Letrën standarde për tenderuesin e eleminuar të datës 13.03.2020 tenderi i OE të rekomanduar për kontratë është shpallur i papërgjegjshëm me arsyetimin se nuk kanë prezentuar stafin e kërkuar konform kërkesave 68 dhe 69 të kërkesave të dosjes së tenderit.
Në dy vendimet e lartëcekura të AK.operatori i rekomanduar për kontratë" "Mirusha Company" Shpk-Klinë" nuk ka parashtruar ankesë andaj sipas ekspertit shqyrtues ky OE konform nenit 4 të LPP-së.paragrafit 1.pika 26 është dashur të shpallet palë pa interes material.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues se oferta e OE "Asfalti"Shpk nga AK gjatë rivlerësimit konform vendimit të OSHP-së PSH.nr.202/20 duhej të shpallej e papërgjegjshme.sipas ekspertit shqyrtues ky pretendim nuk qëndron ngase në vendimin e OSHP-së kërkohet nga AK që konform nenit 72 të LPP-së të kërkoj sqarime nga OE "Asfalti"Shpk lidhur me pajisjen mikser.citoj një pjesë të vendimit të OSHP-së"Për Panelin Shqyrtues është e paqartë se për çfarë devijimesh bëhët fjalë dhe a konisderohen devijime të vogla(në pamundësi të mbahet seanca me pale ku detalisht do të ishte sqaruar paneli shqyrtues nga palët).

Pretendimet ankimore të OE ankues janë pjesërisht të bazuara.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "ASFALTI" SHPK-PEJË

Përgjigje në Pretendimin

Lidhur me pretendimin e OE ankues"Asfalti"Shpk se AK gjatë fazës së rivlerësimit të tenderit sikurse edhe në disa raste tjera të rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka rekomanduar për kontratë OE të cilët kanë ofruar çmim më të lartë sesa OE ankues "Asfalti"Shpk duke bërë shkelje të nenit 1 dhe nenit 6 të LPP-së. eksperti shqyrtues nuk pajtohet me këtë pretendim të OE ankues sepse në këtë aktivitet të prokurimit si kriter për dhënie të kontratës nuk ka qenë çmimi më i ulët por si kriter ka qenë kriteri "tenderi ekonomikisht më i favorshëm" ku në këtë aktivitet të prokurimit janë përcaktuar dy nënkritere sipas poentimit dhe ky pretendim ankimor nuk qëndron.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues "Asfalti "Shpk se AK ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE "Mirusha Comapny"Shpk e cila nuk ka vazhduar afatin e validitetit të tenderit dhe ky operator me plotë vetëdije tërhiqet nga ky aktivitet i prokurimit duke mos shprehur interesim.eksperti shqyrtues pajtohet me këtë pretendim të OE ankues dhe një përgjigjie më të plotë për këtë pretendim e kam dhënë në trajtimin e këtij pretendimi tek operatorit tjetër ankues "Shkëmbi"Shpk

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se OE "Shkëmbi" Shpk tek nënkriteri i dytë i kriterit për dhënie të kontratës "tenderi ekonomikisht më i favorshëm" ka ofruar 24 muaj (2 vite) për periudhën e mirëmbajtjes pas pranimit teknik.eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së.PSH.nr. 202/20 të datës 21.04.2020 dhe sipas këtij vendimi AK obligohet të kërkoj sqarime konform nenit 72 të LPP-së nga OE "Shkëmbi"Shpk.një përgjigjie më të detajuar e gjeni më lartë tek pretendimi i OE "Shkëmbi"Shpk.

Oferta nga OE "Shkëmbi"Shpk

Nr	Nën kriteri	Koeficient	Përgjigjie OE
1	ÇMIMI	0.70	889.846.02 €
2	OPERIMI MIRËMBAJTJA PAS PRANIMIT TEKNIK. PERIUDHA GARANTUESE NË MUAJ	0.30	6 vite garancion në Cilësi. 2 vite Mirëmbajtje Dimrore

Konsideroj që pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "AGIM MORINA" BI-MALISHEVË

Përgjigje në Pretendimin

Lidhur me pretendimin e OE ankues"Agim Morina"BI.se AK gjatë fazës së rivlerësimit të tenderit ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE i cili ka ofruar çmim më të lartë sesa OE ankues "Agim Morina"BI duke bërë shkelje të të LPP-së.eksperti shqyrtues nuk pajtohet me këtë pretendim të OE ankues sepse në këtë aktivitet të prokurimit si kriter për dhënie të kontratës nuk ka qenë çmimi më i ulët por si kriter ka qenë kriteri "tenderi ekonomikisht më i favorshëm" ku në këtë aktivitet të prokurimit janë përcaktuar dy nënkritere sipas poentimit dhe ky pretendim ankimor nuk qëndron.

Nëse OE ankues ka pretenduar për ndonjë pretendim tjetër lidhur me OE të rekomanduar për kontratë.eksperti shqyrtues sqaron se ka ofruar përgjigjie ndaj dy OE tjerë ankues të sqaruara më lartë.

Pretendimi ankimor është i pabazuar

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura. eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të **pranohen si pjesërisht të bazuara**.të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim.**

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues –KOMUNA E KLINËS
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – "SHKËMBI"SHPK
- OE ankues – "ASFALTI"SHPK
- OE ankues – "AGIM MORINA"BI